



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE PUBLIC HOUSING ENTERPRISE

Adr: Rr. "Xhevdet Doda" nr. 32 - Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: _____

Data: _____

Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e "Punëtorit të Elektrikës" në Ndërmarrjen Publike Banesore - SHA me seli në Prishtinë.

Nr. i pozitave: 6 (gjashtë)

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Kryen punët elektrike; hapja e kanaleve, vrimave dhe foleve, shtrirja e kabllave dhe përçuesve, shtrirja e gypave, vendosja e kutive dhe tabelave, lidhja e qarqeve sipas skemave të instalimit, montimi i elementeve të instalimit, montimi i tabelave (ormanëve), montimi i kyçësit shtëpiak, kryerja e tokëzimit, instalimi i rrufepritësit, instalimi elektrik i një banese, vendosja e pajisjeve ndriçuese, instalimet mbi sipërfaqen e murit, instalimet elektrike në dysheme, instalimi i burimeve rezervë, instalimi i rrjetit të antenave televizive, instalimi i linjave telefonike dhe instalimi i interfonit.
- Është përgjegjës për punët e Departamentit të Mirëmbajtjes në punët e rrjetit të energjisë elektrike të tensionit të ultë.
- Zbaton detyrat dhe aktivitetet operative të përcaktuara nga Udhëheqësi i Departamentit të Mirëmbajtjes si dhe koordinon punët që lidhen me mirëmbajtjen e instalimeve të energjisë elektrike në hapësirat ku NPB-ja operon si në mirëmbajtjen e rrjetave ekzistuese, riparimin e rrjetave të tensionit të ulët si dhe shtrimin dhe funksionalizimin e rrjetave me nivel të ulët të tensionit sipas kërkesave të NPB-së.
- Përgatitë dhe vendos në funksion energjinë elektrike nga kutia shpërndarëse dhe nga kutia deri në trafon furnizues të kyqjes së hapësirave të NPB-së.
- Mbanë përgjegjësi për materialin e shpenzuar si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPB-së për punët e mirëmbajtjes së instalimeve të energjisë elektrike.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë

- Udhëheqësi i Departamentit të Mirëmbajtjes mund t'a ngarkojë me detyra tjera sipas nevojës së NPB-së
- Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhër të menaxhmentit mund t'i zëvendësojë dhe të kryen detyrat tjera.
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga menaxhmenti

Raportimet

Bartësi i vendit të punës i raporton Udhëheqësit të Departamentit të Mirëmbajtjes

Kualifikimet

- Shkolla e mesme / Çertifikatë në lëmin e kërkuar
- Bartësi i vendit të punës duhet të ketë së paku 1 vit përvojë pune .

Kualifikimet tjera

- Punëtori i Elektrikes duhet të ketë përvojë në fushën e elektrikes
- Aftësi të mira në punën ekipore.
- Aftësi të mira komunikuese.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati duhet t'i dorëzoi këto dëshmi:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit dhe të përvojës së punës, si dhe
- Kopjen e Lejes së Njoftimit

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, Rruga "Xhevdet Doda", p.nr., Prishtinë** ose përmes e-mailës zyrtare: burimet.njerezore@npbanesore.com. Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Konkursi është i hapur nga data 13.04.2019-27.04.2019